

Vlerat Olimpike - Loja e Kujtesës

Kohëzgjatja: 40 minuta

Grupi i synuar: Të rinjtë të moshës 9-15 vjeç.

E mundur edhe me grupe të rinjsh, por diskutimi pasues duhet përshtatur.

Numri maksimal i grupit: rreth 15 pjesëmarrës.

Materiali: Skeda/karta me figura, gërshërë.

Drejtues loje: 1

Përmbledhje

Loja e kujtesës nëkupton që fëmijët të lidhin dy skeda/karta të njëjta.

Skedat përmbajnë foto, pamje nga Lojërat Olimpike dhe përfaqësojnë Vlerat Olimpike të Përsosmërisë, Respektit dhe Miqësisë.

Pas lojës, pjesëmarrësit ftohen të identifikojnë vlerat e treguara në skeda dhe të diskutojnë rreth tyre.

Përgatitja (mësuesi/drejtuesi i lojës)

- Njohja me lojën dhe skedat (rradha 1 = fotot e Përsosmërisë; rradha 2 = fotot e Respektit, rradha 3 = fotot e Miqësisë)
- Fotokopjo skedat/kartat (ju mund të dëshironi t'i fotokopjoni ato në karton/letër të trashë). Përgatisni një palë skeda/karta për secilin grup me dy deri në katër pjesëmarrës. Pritini 18 skedat/kartat dhe përziejini ato.

Udhëzime

Loja e Kujtesës

- Shpjegoni se ka 9 çifte kartash të njëjta me fotot e imazheve të Lojrave Olimpike. Synimi është identifikimi i çifteve të njëjta të kartave dhe bashkimi i tyre (lojë klasike e kujtesës).
- Formoni grupe të vogla me nga tre-katër vetë dhe shpërndani nga një palë karta për secilin grup.
- Shpjegojini si të luajnë : Secili grup duhet të përhapë dhe vendosë kartat mbrapsht në dysheme. Me rradhë, secili person kthen/hap vetëm dy karta. Kur një lojtar gjen dy karta të njëjta, atëherë ai/ajo ka përsëri radhën. Nëse kartat nuk përputhen, ato do të duhet të kthehen mbrapsht sërish në të njëjtin vend siç ishin. Më pas është radha e një lojtari tjetër të kthejë/hapë dy karta, dhe kështu me radhë .
Fituesi është lojtari i cili ka bashkuar më shumë çifte kartash deri në fund të lojës.

Klasifikimi i vlerave Olimpike

- Pasi loja të ketë mbaruar, shpjegojini pjesëmarrësve se çdo foto përfaqëson një nga tre vlerat Olimpike (Përsosmëria - Respekti - Miqësia). Kërkojuni atyre të identifikojnë se cilat vlera përfaqëson secili çift kartash.
Në varësi të njohurive mbi Vlerat Olimpike që ka grupi, mund të jetë e nevojshme që ato të prezantohen më përpara.
- Ju mund të praktikoni lojën me të gjithë grupin, ose secili grup t'a praktikojë atë më vete, dhe më pas të diskutohet bashkarisht.

Diskutim

- Loja e kujtesës është një mënyrë e mirë për prezantimin e diskutimit rreth Vlerave Olimpike.
- Pavarësisht se vlerat janë të përfaqësuara më vete në këtë lojë, është e rëndësishme të theksohet fakti se tre vlerat janë të lidhura me njëra-tjetrën, në rastin e sportit, konkurrencës dhe Lojrave Olimpike: Çfarë do të ishte përsosmëria pa miqësinë? Apo miqësia pa respektin dhe përsosmërinë? Një kampion i vërtetë është dikush që i ndjek dhe zbaton që treja vlerat!

Vlerat Olimpike – Skedat / Kartat e Kujtesës

